

20101242445

L I G J
PËR NGARKIM ME BORXH TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË NË BANKËN
EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA
PËR PROJEKTIN PËR PËRMIRËSIMIN E VIJËS HEKURUDHORE TË
KORRIDORIT 10

Neni 1

Republika e Maqedonisë ngarkohet në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim me hua në shumë prej 17 600 000 eurosh e dedikuar për realizimin e Projektit për përmirësimin e vijës hekurudhore të Korridorit 10.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshje për hua për Projektin për përmirësimin e vijës hekurudhore të Korridorit 10, që do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Në emër të Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen për hua nga paragrafi 1 i këtij neni, do ta nënshkruajë ministri i Financave ose personi i autorizuar nga ai.

Neni 3

Afati për pagesën e huas nga neni 1 i këtij ligji është 15 vjet, me grejs periudhë të përfshirë prej tre vitesh.

Shkalla vjetore e kamatës është shkallë e kamatës variable gjashtëmujore EURIBOR e rritur për 1%, në nivel vjetor.

Republika e Maqedonisë do t'i paguajë Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim provizion të njëhershëm në lartësi prej 1% të shumës së huas.

Për shumën e mjeteve të patërhequra nga huaja, Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim do t'i paguhet provizion në lartësi prej 0,5% të shumës së mjeteve të patërhequra nga huaja në nivel vjetor.

Neni 4

Projektin do ta implementojë Ministria e Transportit dhe Lidhjeve nëpërmjet Ndërmarrjes Publike për Infrastrukturë Hekurudhore "Hekurudhat e Maqedonisë" - Shkup, të cilat do të lidhin Marrëveshje për implementim për rregullimin e të drejtave dhe detyrave të ndërsjella.

Neni 5

Republika e Maqedonisë huan nga neni 1 i këtij ligji, do ta paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".